



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.03.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2016 për projektin “Programi financiar për shpërndarjen e energjisë elektrike””. *(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermani Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Arben Pëllumbi, Dritan Bici dhe Edmond Leka.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani dhe Lefter Koka.

Të ftuar:

Ilir Bejtja – Zëvendësministër në MEI

Agim Bregasi - Drejtor në MEI

Ilda Malile - Drejtore në OSHEE

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi – Mirëmëngjesi!

Formalisht fillojmë mbledhjen e komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2016 për projektin “Programi financiar për shpërndarjen e energjisë elektrike””.

Relatore është zonja Gjermani.

Ftoj zonjën Gjermani të bëj një prezantim të shkurtër dhe më pas do të flasim zoti zëvendësministër dhe përfaqësuesit e tjerë të ministrisë.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zoti kryetar!

Këtë periudhë kemi diskutuar në komisionin dhe kemi miratuar në parlament disa marrëveshje ndihmë dhe bashkëpunim nga qeveria gjermane. Projektligji që po diskutojmë sot synon ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1, nëpërmjet së cilës qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë një kredi të butë dhe një shumë financimi nga KfW-ja për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1”.

Në përgjithësi sektori i energjisë ka marrë vazhdimisht mbështetje nga qeveria gjermane, ndërkohë që programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1 do të ndikojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rritjen e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët.

Po ashtu, projekti do të mbështesë dixhitalizimin e menaxhimit të rrjetit të OSHEE-së, duke zgjeruar dhe përmirësuar qendrën e kontrollit dhe shpërndarjes me një sistem të fjalës së fundit për sistemin e kontrollit dhe menaxhimit të të dhënave. Furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike do të përmirësojë klimën e biznesit dhe pa dyshim edhe kushtet e jetesës në Shqipëri.

Kur flasim për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike 1”, flasim për shumat e mëposhtme: një kredi e butë e KfW-së, e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim në vlerë 30 milionë euro nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t’u mbështetur, nuk mund të zëvendësohet nga projekte të tjera, dhe një shumë financimi rreth 2 milionë euro për masat e nevojshme

shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit. KfW-ja përjashtohet nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave që do të lidhen nëpërmjet KfW-së, marrësve të huasë dhe shumave të financimit.

Pak a shumë ky është informacioni dhe pa dyshim do të diskutojmë edhe me kolegët, që vijnë nga ministria.

Unë kam disa shqetësime, që mbase nuk janë shumë të qarta në relacion. Këtu thuhet: “Nëse projekti vlen për t’u mbështetur”. Zoti zëvendësministër mund të na ndihmonte me një shpjegim më të hollësishëm se për çfarë projekti bëhet fjalë. A është gati nga ministria? Kur do të fillojë zbatimi i tij? Çfarë impakti do të ketë?

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Ju lutem, zoti Bejtja, bëni një shpjegim! Pastaj do të fillojmë me pyetjet.

Ilir Bejtja – Për pjesën e marrëveshjes, Zonja Gjermani i sqaroi pak a shumë gjërat.

Marrëveshja është në kuadrin e bashkëpunimit ndërqeveritar me qeverinë gjermane. Si protokoll është firmosur në 2016-n dhe ka qenë subjekt i targeteve, ku duhet të mbërrinte sektori që kjo marrëveshje të bëhej e vlefshme. Targetet, sipas planit të rikuperimit financiar që kemi pasur, kanë qenë të lidhura me nivelin e humbjeve, pra duhet të zbrisnin nën 26%. Ne sot jemi në nivelin 24%. Arkëtimet ishin më shumë se 87%, sot janë 92%. Bëhet fjalë për arkëtimet korrente.

Në këtë kuadër, çdo investim do të jetë i lidhur me targete që duhet të përmbushen dhe do të shkojë në mënyrë eksplicite në projekte, të cilat vlerësojnë përsëri grafikun e uljes së humbjeve dhe të rritjes së arkëtimeve në zona.

Ky është konteksti i projekteve për t’u miratuar në vazhdim me KfW-në, që në këtë rast është administruesi financiar i fondeve të qeverisë gjermane. Ndërkohë, ne mbetemi, gjithmonë, subjekt i monitorimit përmes tyre, edhe nëpërmjet një *roadmap*-i, që e kemi miratuar me vendim qeverie në datën 12 dhjetor. Ne kemi rreth 18 komponentë për të përmbushur, nga të cilët 11 janë të aspektit rregullator dhe të rezultateve që duhet të arrijmë. Pjesa tjetër janë komponente, që kanë të bëjnë me zhvillimin e sektorit në faza të ndryshme të tij.

Si elemente treguese për hyrjen në fazën e dytë, pra pas tremujorit të tretë të vitit 2019, është përmbushja e 11 komponentëve të parë në masën mbi 70%. Pra, mbetet gjithmonë për t’u vlerësuar projekt mbas projekti.

Ka edhe një grafik disbursimi, i cili parashikohet në marrëveshjen e huas, që është nga 2019-a deri në 2024-n. Për tremujorin e fundit të vitit 2019 është parashikuar të kemi rreth 3 milionë euro disbursime dhe do të vazhdohet për çdo vit sipas një tablele, ku 2010-a është me 6 milionë euro, pra kemi gjithmonë elemente, të cilat lidhen me arritjen e treguesve që kemi në si sektor.

Niko Peleshi - Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Thuhet se është një kredi e butë. Do të doja të dija se sa është përqindja e interesit.

Nga ana tjetër, marrëveshja është bërë pothuajse 3 vjet më parë, në një kohë kur problematika e humbjeve është ende kritike. Nuk po flas për humbjet për shkak të abuzimeve, por për shkak të cilësisë së rrjetit të transmetimit.

Ndërkaq, në material thuhet se ky premtim skadon nëse nuk realizohet brenda 6 vjetësh, domethënë, ratifikohet e të tjerë. Më bën përshtypje se pse ka kaq vonesë për fillimet e saj dhe për kalimin në parlament, në një kohë kur marrëveshja është bërë gati 3 vjet më parë dhe humbjet janë vërtet kritike në sistem.

Niko Peleshi – T’i mbledhim pyetjet dhe më pas të përgjigjemi.

Po, zoti Marto.

Andrea Marto - ..Thuhet: “Projektligji i mundëson Republikës së Shqipërisë ose marrësve të tjerë...”. Kush janë marrësit e tjerë? Këto kompanitë...?

Niko Peleshi – Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi - Në vazhdim të pyetjes që bëri zoti Marto për marrësit e tjerë, doja të dija nëse kemi ndonjë projekt konkret për investimet në tensionin e lartë, të mesëm apo të ulët? Pra, ku synojmë të vazhdojmë me përmirësimet për uljen e humbjeve?

Niko Peleshi - Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Shqetësimi im ka të bëjë me atë që tha kolegu Baraj për sa i përket interesave të huas, kohën e shlyerjes apo kushtet e tjera të veçanta.

Kryetar, ndoshta po hap një çështje pak më të përgjithshme, por përgjithësisht parlamenti miraton huat, të cilat kanë tre elemente: shumën, interesin, periudhën e shlyerjes dhe elemente të veçanta, sepse ka komision fillimi e të tjera. Kjo marrëveshje, me aq sa unë e kam kuptuar, nuk i ka të gjitha këto elemente.

Kryetar, pse duhet të miratojë një gjë të tillë Kuvendi? Unë e kuptoj që ky është një angazhim i qeverisë gjermane, që i jep qeverisë shqiptare 30 milionë. Do të vijmë përsëri për të miratuar çdo marrëveshje konkrete? Nëse vijmë për çdo marrëveshje konkrete, pse duhet

t'i humbim kohën si qeverisë, ashtu edhe Kuvendit për një gjë që është premtim? Përderisa për të disbursuar 3 milionët që thatë se keni planifikuar këtë vit ju do të vini me një marrëveshje specifike (në Kuvend vihet për të marrë miratimin kur merr hua me të gjithë elementet e saj), atëherë pse duhet të vijmë sot?

Marrëveshjet nuk mund t'i amendojmë, sepse ato vijnë *on block*, kurse ne i pranojmë ose nuk i pranojmë. Megjithatë, për të kuptuar pak më mirë elementet, në nenin 1, pika 3 e tekstit të marrëveshjes bëhet fjalë edhe për gjëra shtesë në të ardhmen. Është pak e lirë. Nëse duhen më shumë lekë, hyn kjo marrëveshje. A kanë ndonjë kufizim këto para, sepse shtesa mund të jetë më shumë se 30 milionë dhe i bie që shtesa, për të cilën këtu nuk flitet fare, të jetë më e madhe se vetë marrëveshja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por shtesa është më e madhe se vetë marrëveshja. Kështu është lënë në mënyrë shumë të përgjithshme.

Pjesa e ngelur deri në fund të vitit 2022 është më tepër sfidë për qeverinë për të arritur afatet.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Nëse nuk ka pyetje tjetër, ju lutem përgjigjuni sipas radhës së pyetjeve.

Ilir Bejtja – Kërkesa për financimin në fjalë është e vitit 2014 dhe ne ia kemi drejtuar këtë tryezës së përbashkët të protokollit me qeverinë gjermane, e cila mbledhet një herë në tetor dhe një herë në nëntor për mbylljen e protokollit të vitit për financimet në PBA dhe për vitin e radhës.

Është gjykuar nga tryeza e përbashkët që të kalojë në protokoll në nëntor të vitit 2016. Unë nuk mund t'ju them pse në vitin 2016. Është një protokoll, i cili ka nisur nga viti 2009 me qeverinë gjermane dhe vazhdon çdo vit në funksion të nevojave që ne kemi, mundësive që ata kanë për financim si qeveri dhe ndarjes që ne bëjmë në bazë sektori. Nga ky financim nuk përfiton vetëm sektori i energjisë elektrike, por të gjithë sektorët. Në vite të ndryshme ne kemi përfituar më shumë, por ka pasur edhe vite të tjera që nuk kemi përfituar nga programi i qeverisë gjermane.

Në vitin 2016, pas shumë përpjekjesh ne arritëm përsëri ta fusim në protokoll në varësi të hapësirave që ne kemi pasur në buxhet për financimin e sektorit, sepse ka tavane të përcaktuara për çdo vit. Në vitin 2017 ne kemi pasur 7 miliardë lekë, në vitin 2018 5,5 miliardë lekë, kurse këtë vit kemi 3 miliardë lekë hapësirë buxheti. Kjo është arsyeja që as

disbursimi nuk bëhet i gjithi njëherësh, pra në momentin kur ne do të kemi mundësi ta thithim financimin.

E dyta, varet edhe nga treguesit.

Ju thatë se jemi në një moment shumë kritik për humbjet. Unë do të thosha se ky është një rekord, që nga dita e parë, kur ne kemi filluar të kemi elektricitet në Shqipëri, nuk i kemi pasur humbjet më të vogla se 24%. Humbjet në Shqipëri kanë qenë gjithmonë mbi 27-28%. Arsyeja kryesore është, sepse shpërndarja jonë në linjat me tension të ulët ka qenë gjatë gjithë kohës me tela ajrorë, që çlirojnë shumë energji gjatë kohës së transmetimit. Pra, nuk është thjesht një element që lidhet me ndërhyrjet në rrjet apo me manipulimet e rrjetit, por lidhet edhe me cilësinë e rrjetit që ne kemi.

Në momentin që flasim, ne kemi arritur një 24% humbje jo thjesht për shkak të masave organizative apo të dorës së fortë për t'i detyruar njerëzit që të mos ndërhyjnë në mënyrë të paligjshme, por edhe nëpërmjet investimeve që kemi bërë edhe në linjat e tensionit të mesëm, pra kemi kaluar nga 60 kilovolt në 20 kilovolt në një pjesë të madhe të rrjetit. Janë bërë shumë nënstacione të reja, fidera të rinj, janë investuar kabina të reja, të cilat janë 20-04 dhe i gjithë 04-shi i ri që është vendosur është me kabëll të tipit ABC, që ka një normë shumë të ulët humbjeje, sepse është i izoluar. Në këtë aspekt, themi që kemi arritur disa rekorde, të cilat lidhen edhe me investimet, edhe me masat e marra.

Vazhdojmë të kemi targete absolutisht të vështira, të cilat tashmë nuk janë më të fillimit, kur ne kishim 53% humbje, por lëvizin me 2-3 % të humbjeve në vit, në funksion të investimeve që bëjmë në rrjet. Pra, situata kritike (nëse do të thoshim se është e tillë), lidhet me sigurinë e furnizimit, sepse ne kemi varësi shumë të madhe nga kushtet hidrike.

Elementet e tjera, që lidhen me shpërndarjen janë që të gjitha super të përmirësuara. Mjafton t'ju them se në vitin 2013 të ardhurat tona nga sistemi i shpërndarjes kanë qenë vetëm 32 miliardë lekë ndërsa tani kemi mbi 66 miliardë lekë të ardhura. Kjo nuk vjen vetëm, sepse ne kemi rritur bazën e pagesve, por sepse kemi ulur shumë ndjeshëm humbjet. Kemi një diferencë me 29% nga dhjetori i vitit 2013. Kujtoj se kemi qenë me 53% humbje.

Faturën korrente e kemi mbledhur me 48%, ndërsa sot e mbledhim me 92%. Nuk kemi pasur asnjëherë formulë të ndërprerjes së energjisë për ata që nuk e paguajnë. Tani për çdo mospagesë më tej se 30 ditë nga data që i ka mbërritur fatura, e cila është koha e pagesës, abonentit i ndërpritet energjia, gjë që tregon se sistemi ka filluar tashmë të operojë shumë më mirë.

Ajo që na duhet sot është kontrolli i automatizuar. Kemi nisur me procesin SCADA, kemi bërë qendrën dispeçer dhe kemi hedhur në to, tani që flasim, vetëm 35-

kilovoltshin dhe po vazhdojmë të hedhim në sistem edhe 20 kilovoltshin. Do të hedhim të gjithë sistemin dhe do të arrijmë të kemi një kontroll të plotë, të automatizuar të shpërndarjes dhe të ndërprerjes apo të lidhjes së energjisë në të gjithë territorin, pa asnjë lloj dallimi dhe pa asnjë lloj difference.

Besnik Baraj – Ilir,

Kur thashë situatë kritike, unë nuk kisha parasysh krahasimin me vitin 2013, por kam parasysh krahasimin me vendet fqinje në lidhje me humbjet në tërësi dhe për këtë aspekt, unë do të thosha se humbjet për ekonominë tonë dhe për peshën që zënë këto humbje në masën 24%-përqind, janë shumë.

Ne duhet ta krahasojmë veten se çfarë ofron në përgjithësi një investim për përmirësimin e teknologjisë dhe në situatën në të cilën ndodhemi. Për këtë e kisha, por unë e kam shumë të qartë progresin e bërë. Për mendimin tim, sfida fillon tani në aspektin e investimeve.

Ilir Bejtja – Aktualisht, kemi ndërhyrë në një pjesë të konsiderueshme të rrjetit të shpërndarjes, sidomos në tensionin e ulët, por jo në shumicën e tij. Pjesa e tij dërmuese mbetet me një vjetërsi 35-40-vjeçare, me tel ajror. Që ta bëjmë këtë, duhet të kemi një ritëm më të lartë investimesh.

Hapësira e parashikuar në VKM-në për planin e konsolidimit financiar, që do të miratohet së shpejti (jo ai që kemi pasur, që ishte shumë akomodues), është rreth 7-7,5 miliardë lekë në vit. Kjo do të thotë që do të duhet një farë kohe që ne të kompletojmë një program të plotë dhe të arrijmë që në vitin 2022 të kemi 15% humbje, ky është objektivi, targeti. Se sa duhet të jenë, po ju them: kemi vende ku ne kemi investuar në mënyrë të plotë, pra linja është 110, 20/04 dhe me kabina të reja, matës dixhitalë mund të shkohet edhe te 4%-5%, por kjo është diçka që u takon disa viteve më tutje.

Niko Peleshi – Zoti Pëllumbi, kishit pyetje?

Arben Pëllumbi – Në fakt, zoti Bejtja e sqaroi pak a shumë atë që unë desha të pyesja. Ideja ishte që rrjet pa humbje nuk ka, pra kjo gjë nuk ekziston teknikisht. Ndaj dua të di: sa është minimumi teorik, jo ai praktik? Ju e thatë që mund të jetë 4%-5%. Është...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di nëse mund të shkojë 2%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Bejtja – T'ju jap një shembull. Në vitin 2015 kemi ndërhyrë te lagjia, që është mbrapa Qytetit Studenti, e cila është bërë e gjitha me kabina të reja 20/04. Kur filluam investimin humbjet kanë qenë 36%, ndërkohë sot kemi 100% arkëtime, ndërsa 3,7% humbje

në atë bllok. Por ky nuk mund të jetë standard për të gjithë vendin, sepse jo të gjithë janë të grupuar në atë formë. Kur shkojmë në fshat, shtëpitë janë minimumi 500-600 metra larg njëra-tjetrës.

Mund të ndodhë që të kesh arritje të tilla në zona intensive urbane.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Sa është kufiri, 100%?

Ilir Bejtja – Në këtë bllok, po.

I kemi të gjithë me kablllo ABC, nuk kemi më faturim aforfe dhe çdokush paguan faturën që konsumon. Pra, nuk është çështje që ne nuk kemi mundësi apo nuk dimë ta bëjmë, por kjo lidhet me kapacitetet që kemi për investim.

Pjesë goxha e rëndësishme është edhe investimi, që do të bëhet nëpërmjet kësaj kredie, sidomos për zonat intensive urbane, ku ne kemi parashikuar edhe nënstacione të rëndësishme, por, mbi të gjitha, kompletimin me sistem të automatizuar kontrolli, me SKADA.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar zonja Gjermani për pyetje.

Ilir Bejtja – Në fakt, janë edhe disa pyetje të tjera për t'u kthyer përgjigje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eglantina Gjermani – Në rregull.

Ju e thatë pak më parë, zoti Bejtja, pjesën e arkëtimeve, që unë e kam pak merak, ndaj thjesht pyes: sa është rritur përqindja e arkëtimeve? Në çfarë niveli jemi dhe ku do të arrijmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju e përmendët pak në fillim, por a kemi ndonjë objektiv sa kemi arritur tani dhe ku do të shkojmë?

Faleminderit!

Ilir Bejtja – Sipas planit të konsolidimit financiar të sektorit, objektivi ynë është që në vitin 2022 arkëtimet korrente t'i kemi 95%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

92.

Provigionimin e planifikuar në tarifë e kemi me 12,7%. Tarifa e sotme parashikon që ne të kemi 87,3% arkëtime dhe rreth 32% humbje. Pra, ne jemi shumë komodë me këta tregues.

Një nga arsyet pse kemi paraqitur një plan të ri të konsolidimit financiar është sepse kemi ndryshuar edhe targetin e humbjeve deri në vitin 2022, edhe objektivin që ne kemi për rritjen e arkëtimeve, por, mbi të gjitha, edhe rritjen e cilësisë së furnizimit.

Siç ju thashë, ne mund të mburremi sot që nuk kemi ndërprerje energjie ose mbulojmë me furnizim energjie të gjithë territorin, por ka vende ku kjo shkon në një cilësi tejet të dobët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për shkak të linjave ekzistuese.

Për sa i përket pyetjes që lidhet me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më duket se pyetjen lidhur me projektet konkrete e ezaurova, pra lidhen me nënstacione, linja në 20 dhe në 0,4, që shoqërojnë nënstacione dhe fida, si dhe sistemi SKADA (sistemi i automatizuar i kontrollit).

Për sa u përket interesave të huas, siç jua thashë, marrëveshja është marrëveshje bazë, marrëveshje tip, e cila vazhdon në të njëjtën linjë, me të gjithë programin që ne kemi pasur për ndihmë financiare nga qeveria gjermane.

Marrëveshja konkrete e huas do të vijë pas jush, ne e kemi gati, por është duke u diskutuar... Domethënë, duhet të ketë ardhur për diskutim në komisionet parlamentare. Pas miratimit të kësaj marrëveshjeje, shlyerja dhe zbatimi i saj janë deri në vitin 2024 me një tabelë, që tregon se për nëntë vjet bëhet disbursimi i plotë i kredisë.

Interesat mund t'jua u lexoj siç parashikohen në marrëveshje: llogaritja e interesave. Interesi për shumën e huas do të jetë një normë fikse, e përcaktuar me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje huaje, bazuar në normat e interesit fikse të përcaktuara nga KfW-ja në ditën e dytë bankare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si tarifë është 0,25%, si angazhim, dhe 1% për normën e plotë të interesit.

Kaq i kemi në program.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – U hap çështja e humbjeve. Me përafërsi, sa na kushton 1% humbje në vit?

Ilir Bejtja – Konsumi ynë ose energjia që blejmë është rreth 6,4 terawat. 1% humbje duhet të jetë rreth 0,6 tera, afërsisht 60 giga, të cilën, po ta shumëzosh me çmimin e sotëm të energjisë rreth 60 euro, shkon rreth 12 milionë dollarë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

1%, me çmimin e sotëm të importit, sepse të gjitha humbjet i mbulojmë me import.

Ilir Beqaj – Nëse humbjet na kushtojnë 12 milionë dhe rikuperimi i humbjes teknike për 1% kushton 50 milionë, a ia vlen të investojmë?! Më mirë të rrimë me humbje teknike.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çdo vit ne kemi humbje dhe flasim për ulje të humbjes, e cila shoqërohet me investime. Me programin tonë ulim humbjen që kemi rreth 3% në vit, pra për 4 vjet të shkojmë në 15%, 14,9...

Ilir Beqaj – E mbyllim vitin me 23,2%...

Ilir Bejtja – Vitin që vjen e kemi planin 21,5%...

Ilir Beqaj – Përgjithësisht është 17% dhe 7%, kështu kemi ardhur. 7% janë jotekniket dhe 17% janë tekniket.

Ilir Bejtja – Nuk ka një ndarje të tillë as përgjithësisht...

Ilir Beqaj – Që ka ndarje, ka...

Ilir Bejtja – Nuk ka, se nuk ka vlerësim. Ne kemi vlerësim kompleksiv për humbjen, pra humbja është 24%...

Ilir Beqaj – Të miat mund të jenë të pasakta, por, në qoftë se nuk keni ndarje teknike dhe joteknike...

Ilir Bejtja – Nuk mund të ketë.

Ilir Beqaj – Mund të ketë patjetër..

Ilir Bejtja – Nuk mundet...

Ilir Beqaj – Dihet se cilat janë jotekniket...

Ilir Bejtja – Nuk mundet, sepse nuk i di askush...

Ilir Beqaj – Jotekniket?

Ilir Bejtja – Nuk mundet. Ne i verifikojmë nëpërmjet programit të investimeve si humbje totale. Unë nuk e di nëse sot ka 5% vjedhje dhe nuk e di as se kush e vjedh. Çdo gjë vjen në mënyrë imagjinare ose me analiza, pra që ne mendojmë se duhet të jetë më e lartë ose më e ulët. Në flasim për uljen e humbjeve nga 24% në 15% dhe jo të humbjeve teknike nga kaq në aq.

Ilir Beqaj – Imagjinata dhe analiza janë dy gjëra krejt të ndryshme. Fakti që në seri kohore, në kohë mbrapa, çdo vit zbulohen vjedhje në konsumatorë familjarë ose jofamiljarë, të bën të mendosh se vjedhje ka ende. Mbi këtë ndërton një seri kohore dhe bën analizën dhe jo imagjinatën, se janë dy gjëra të ndryshme.

Ilir Bejtja – Jam shumë i qartë, prandaj po ju them se këto punë nuk bëhen duke i marrë me mend. Sot ne kemi ardhur në një pikë kur vjedhja është diçka që nuk mund ta

identifikojmë si vjedhje, por kemi humbje kompleksive. Nëpërmjet investimit që bëhet, kemi ulje të humbjeve në përgjithësi. Unë nuk mund të them se sa nga kjo humbje vjen për shkak të rezistencës omike që kanë telat ajrorë dhe sa prej saj vjen nga vjedhja. Po ta kishim kapur vjedhësin tani, do t'i kishim të denoncuar...

Ilir Beqaj – Përderisa policia arreston për lidhje të paligjshme, do të thotë që ka, se po ndodhin. Besoj se njoftoheni edhe ju...

Ilir Bejtja – Sigurisht që ndodhin...

Ilir Beqaj – Nuk kam përfunduar. Që janë 24% biem dakord. Nëse nuk janë 17% me 7%, mund ta kemi gabim, por ju duhet ta keni të qartë. Për t'i ulur 10% na duhen 500 milionë investime, për të shkuar nga 24% te 14%...

Besnik Baraj – Dhe për katër vjet e nxjerr veten...

Ilir Beqaj – 500-milionëshi? Po 12 milionë në vit?

Besnik Baraj – Në katër vjet bëjnë 48 milionë...

Ilir Beqaj – Po 500-milionëshin ku e gjetë? I ke që ditën e parë? Po vlera e parasë në kohë? Që vitin e parë investohen të gjithë 500 milionët? Marrëveshjes iu deshën 3 vjet të vinte në parlament nga qeveria, nga data e firmosjes në vitin 2016. Nëse është apo nuk është, mbetet për t'u parë...

Besnik Baraj – Edhe 6 vjet po të jetë kthimi, është mirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Bejtja – Zoti Beqaj, ju mund të flisni me kolegët, por ju po flisni për ne...

(Diskutime pa mikrofon)

Niko Peleshi – Të lutem, zoti Bejtja, do të flisni kur t'jua japim fjalën! Pa merak që do ta keni kohën tuaj.

Ilir Beqaj – Në lidhje me pjesën joteknike, të gjitha sistemet kur vijnë te 6% apo 7%-shi nuk e ulin më, sepse bëhet irracionale. Zëvendësministri tha se ka zona nëpër fshatra, që janë aq larg, sa do të pranosh një kompromis humbjesh, sepse është shumë e madhe...

Ne në mbledhjen e tarifave dhe të taksave themi: “Në qoftë se pjesa e administrimit bëhet më e rëndë se pjesa e vetë të ardhurave, nuk ia vlen të merresh me këtë punë”.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë nuk e di, se sa e ka.

Ne kemi ende një dukuri, që nuk e kanë vendet e tjera. U mbyll viti i kaluar dhe ende familjari zë 45% të konsumit, kurse në botën e zhvilluar rezidenciali zë shumë më pak.

Së pari, ka industri dhe nuk bëhet fjalë të ketë humbje jo teknike.

Së dyti, është shumë më e madhe pesha, janë shumë më pak si pajtimtarë dhe është shumë më i lehtë administrimi.

(Mungesë regjistrimi)

Niko Peleshi – Urdhëroni, zoti Bejtja!

Ilir Bejtja - Për të sqaruar analizën ekonomike. Energjia ka dy elemente, të cilat quhen të mira publike: njëra është siguria e furnizimit, pra 100% ne duhet t’jua garantojmë çdo njeriu dhe, e dyta është cilësia. Pra, nuk mjafton vetëm ta kesh, por ta kesh në cilësinë e duhur. Të gjitha këto në total përkthehen në terma të kthimit të investimeve jo vetëm brenda sistemit, por edhe nga sistemet e tjera, të cilat funksionojnë për shkak të forcës motor, që është energjia në të ardhura. Në qoftë se ne themi investojmë 500 milionë euro në energji, kjo nuk do të thotë se patjetër këto para duhet t’i marrim direkt në iks vite nëpërmjet çmimit apo nëpërmjet të ardhurave nga shitja brenda biznesit. Në përgjithësi sistemi ynë punon *cost recovery*, ku pjesa tjetër lidhet me të mirat që i vijnë në përgjithësi të gjithë ekonomisë nga këta dy tregues. Patjetër, që shifrat kanë analizën e ekonomike të tyre. Për shembull, në disa raste kemi miratuar te ju, programin “Për eficiencën e Qytetit Studenti”, ku ato kthehen shumë shpejt rreth 5-6 vjet nëpërmjet kursimit, në raste të tjera norma e kthimit është më e ulët. Për t’ju përmendur W-ACC, në sistemin tonë shkon nga 3%-4%. Pra, kemi norma të ulëta të kthimit të investimeve. Kjo sepse sistemet janë të ndryshme. Në shumë raste kemi investime, të cilat janë të trupëzuara, pra ka një normë amortizimi shumë të ulët. Në raste të tjera, kemi më të lartë, pra në mënyrë të kombinuar kjo është përfitimi që kemi nga investimet në formë financiare, pra kthimi i tyre.

Një tjetër element i rëndësishëm në të gjithë këtë biznes është edhe fakti se humbjet që ne ulim me të vërtetë kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në sistem, por përballojnë edhe një pjesë të mirë të investimeve. Ne nuk është se kemi investuar çdo gjë nëpërmjet kredive që kemi marrë apo mbështetjes që kemi marrë në qeveri. Mjafton t’ju kujtoj se nga qeveria edhe shpërndarja ka marrë në total nga viti 2014 deri tani 63 milionë euro me programin e Bankës Botërore ose 92 milionë dollarë dhe kjo është e dyta. Pra, kaq kemi marrë gjithsej nga qeveria shqiptare. Të gjitha investimet që janë bërë deri në këtë moment që flasim janë rreth 27 miliardë lekë, pikërisht me paratë e përfituara nga ulja e humbjeve dhe nga rritja e arkëtimeve. Pra, mos kujtoni se çdo gjë e mbështet qeveria. Ajo ndërmarrja atje, ose i gjithë sistemi, mbi të gjitha, gjeneron për vete, paguan detyrimet dhe përballon edhe disa sektorë të tjerë, të cilët në shumë raste, si ujësjellësit, nuk i shlyejnë detyrimet e energjisë elektrike, ku duhet edhe atje një reformë, dhe përsëri ia dalim që ne të ofrojmë me cilësi sa më të lartë shërbimin e furnizimit me energji elektrike popullatës dhe ekonomisë shqiptare.

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera?

Ilir Beqaj – Unë jam dakord me parashtrësën tuaj, që efektet pozitive që mund të vijnë të shtrihen edhe në sektorë të tjerë, por po të jetë kështu, në marrëveshje nuk duhet të kemi edhe huamarrës të tjerë përveç Këshillit të Ministrave, sepse, nëse huamarrës do të jetë ndërmarrja, nuk ka rëndësi kush është, ajo do të funksionojë me parimet e një ndërmarrjeje, sepse nuk e lejon të dalë përtej logjikës ekonomike dhe të bëjë vlerësimet që thoni ju. Nëse qeveria merr përsipër dhe thotë: “Unë me lekët e buxhetit të përgjithshëm (siç bëhet pjesërisht me bankën botërore) investoj këtu, sepse mendoj se, përveç rregullimit këtu, mund të sjellë edhe zhvillim ekonomik e të tjerë”, atëherë, duhet t’i dalë për zot të gjithës qeveria, sepse ajo që thatë në fund...

Përderisa ajo është ndërmarrje, do të përfundojë me logjikën e ndërmarrjes, pavarësisht se kush është pronari. Madje, në qoftë se shteti në mënyrë të tërthortë, ndërhyr në atë ndërmarrje, ka rregulla të tjera që nuk e lejon prej MSA-së. Ajo që thatë në fund, lidhur me problematikën e ujësjellësve, nuk duhet t’ua lini barrën ndërmarrjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju atë thatë. Ministria është diçka tjetër, ndërsa ndërmarrja është ndërmarrje dhe nuk ka pse të bëjë subvencionime të fshehta.

Ilir Bejtja – Në librat tanë ne e kemi detyrim që ata duhet ta paguajnë.

Ilir Beqaj – Po, por sa kohë u bë që nuk e paguajnë? Sepse ju e thatë që ata nuk e paguajnë dhe mospagesën e tyre ia keni lënë barrë ndërmarrjes.

Ilir Bejtja – Ia ka lënë qeveria, nuk ia kemi lënë ne, sepse qeveria është pronari dhe ky është vendim i pronarit.

Ilir Beqaj – Duke i lënë të dyja kështu nuk përmirësojmë asnjë nga dy sektorët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka 5 vjet. E kaluam dje reformën e ujësjellësve.

Niko Peleshi – Zoti Pëllumbi, nëse është e nevojshme mund të bëjmë një dëgjese me ndërmarrjet dhe ministrinë.

Ilir Bejtja – I gjithë ky debat lindi për të justifikuar ose për të hapur diskutimin në lidhje me faktin nëse e justifikon investimi kthimin mbrapsht. Prandaj edhe unë pyeta në çfarë tensioni do të investojnë, sepse, për sa kohë investojmë në automatizim, në tension të mesëm dhe diçka në tension të ulët, është e sigurt që ka interes shumë të madh dhe rikthehet. Rastet kur investimi nuk rikthehet siç duhet është, kur në tension të ulët janë ato raste kur nuk ke interes, ndodhet larg apo për arsye politike ti bën disa investime që e di shumë mirë që nuk

do të kthehen. Për këtë marrëveshje që po flasim dhe për këtë projekt nuk diskutohet fare që investimi është me shumë leverdi.

Niko Peleshi - Faleminderit për sqarimet zoti Bejtja!

Hedhim në votim në parim projektligjin. Kush është dakord? Kundër nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, punë të mbarë!

Nëse është e nevojshme, do të kërkojmë një dëgjese me ndërmarrjet ose me ministrinë për çështjet që na shqetësojnë lidhur me energjinë.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA